



STANDARDET E VLERËSIMIT DHE RIAKREDITIMIT TË PROGRAMEVE STUDIMORE

1. Misioni, objektivat dhe administrata

Standardi 1.1 Programi i studimit është në përputhje me misionin e institucionit të arsimit të lartë dhe synimet strategjike, nevojat e shoqërisë dhe është i disponueshëm për publikun. (ESG 1.1)

Treguesit:

Përmbajtja dhe struktura e programit të studimit janë në përputhje me misionin dhe qëllimet strategjike të institucionit/njesisë akademike dhe ai është i disponueshëm për publikun.

- Programi i studimit njih specifikat e pozicionit të IAL në zonën e synuar gjeografike dhe/ose kërkimore.
- Rezultatet e synuara të të nxënësve të programit të studimit janë në përputhje me misionin dhe qëllimet strategjike të institucionit/njesisë akademike dhe ato janë të disponueshme për publikun.
- Ofrimi i programit të studimit mbështetet nga një analizë nevojash e kryer nga institucioni i arsimit të lartë/njësia akademike e institucionit të arsimit të lartë (perspektivat e punësimit, kërkesa për programin nga studentët potencialë, etj.).
- Programi i studimit justifikohet nga institucioni i arsimit të lartë nëpërmjet një argumentimi racional të numrit optimal të studentëve që synon të regjistrojë.
- Objektet dhe pajisjet e dedikuara për zbatimin e programit të studimit janë në gjendje të plotësojnë numrin e studentëve që synohen të regjistrohen.

Standardi 1.2 Programi i studimit u nënshtrohet politikave dhe procedurave për integritetin dhe lirinë akademike që parandalojnë të gjitha llojet e sjelljeve joetike. Dokumentet janë në dispozicion të publikut, ndërsa personeli dhe studentët janë të informuar lidhur me to. (ESG 1.1)

Treguesit:

- Programi i studimit u nënshtrohet procedurave dhe mekanizmave të shkruar për të trajtuar plagjiaturën, pandershmërinë akademike dhe forma dhe lloje të tjera diskriminimi. (Për shembull, Kodi i Etikës, Komiteti i Etikës, Ombudspersoni i Studentëve, softueri përkatës).
- Ka të dhëna se programi i studimit zbaton procedurat që përcaktojnë veçanërisht se çfarë ndodh me rezultatet e softuerit kundër plagjiaturës dhe procesin e saktë që duhet të ndjekin studentët, personeli akademik dhe personeli administrativ.
- Ekzistojnë standarde etike që rregullojnë mësimdhënien dhe kërkimin e programit të studimit dhe të gjithë studentët, pedagogët dhe palët e tjera të interesit njoftohen me to (për shembull, procesverbali i mbledhjes së Komisionit të Etikës, IAL-i informon studentët përmes pakove studentore, doracakëve të studentëve, të dhënave statistikore rreth përdorimit të softuerit kundër plagjiaturës, programeve mësimore që përmbajnë informacion rreth standardeve etike).

- Mekanizmat për monitorimin e sjelljeve potenciale joetike të studentëve, pedagogëve dhe palëve të tjera të interesit të përfshira në programin e studimit janë efikase, zbatohen rregullisht dhe shpërndahen në të gjitha grupet përkatëse (shembull ose dëshmi se si institucioni i arsimit të lartë e zgjidh rastin e sjelljes ose konfliktit joetik, vendime anonime të Komisionit të Etikës për raste të caktuara).

Standardi 1.3 Informacioni përkatës mblidhet, analizohet dhe përdoret për të siguruar menaxhimin efektiv të programit të studimit dhe të aktiviteteve të tjera përkatëse dhe ky informacion është i disponueshëm për publikun. (ESG 1.7)

Treguesit:

- Sistemi i menaxhimit të informacionit përfshin informacione përkatëse, të përditësuara dhe të besueshme dhe janë zhvilluar plane konkrete veprimi për të monitoruar zbatimin e programit të studimit.
- Normat etike dhe politikat e qeverisë në lidhje me mbrojtjen e të dhënave dhe privatësinë e studentëve merren parasysh për realizimin e programit të studimit.
- Studentët dhe personeli i programit të studimit janë të përfshirë në ofrimin dhe analizimin e informacionit dhe planifikimin e aktiviteteve përcjellëse.

Standardi 1.4 Ofrimi i programit të studimit ka mbështetjen e duhur dhe të mjaftueshme administrative për të arritur qëllimet e tij të mësimdhënies, mësimnxënies, kërkimit shkencor dhe shërbimit në komunitet. (ESG 1.6)

Treguesit:

- Të gjitha aktivitetet dhe operacionet e programit të studimit i nënshtrohen një procesi politikash dhe rishikimi që siguron personel adekuat dhe efikas administrativ dhe mbështetje buxhetore.
- Programi i studimit ka administratë të mjaftueshme për të mbështetur nevojat e mësimdhënies dhe të mësimnxënies të studentëve dhe të personelit akademik.
- Personeli administrativ i angazhuar në realizimin e programit të studimit i nënshtrohet një plani të zhvillimit profesional.
- Menaxhmenti i IAL dëshmon se personeli administrativ është i përfshirë strukturalisht në programet e zhvillimit profesional (për shembull, trajnimi gjuhësor, etj.)

Standardi 1.5 Janë zbatuar rekomandimet për përmirësimin e cilësisë së programit të studimit nga procedurat e mëparshme të brendshme dhe të jashtme të sigurimit të cilësisë. (ESG 1.10)

Treguesit:

- Rekomandimet për përmirësimin e programit të studimit janë analizuar, duke përfshirë aktivitetet dhe veprimet që janë ndërmarrë në bazë të proceseve të mëparshme të brendshme dhe të jashtme të sigurimit të cilësisë (për shembull, planet e veprimit dhe raportet për zbatimin e bazuar në rekomandimet e paneleve të ekspertëve, shembuj të rezultateve të arritura në bazë të rekomandimeve nga procedurat e mëparshme të brendshme dhe të jashtme të sigurimit të cilësisë).

2. Menaxhimi i cilësisë

Standardi 2.1 Ofrimi i programit të studimit i nënshtrohet një sistemi të brendshëm dhe funksional të sigurimit të cilësisë, në të cilin përfshihen të gjithë akterët përkatës. (ESG 1.1)

Treguesit:

- IAL ka krijuar një sistem të brendshëm të sigurimit të cilësisë në përputhje me rregulloret kombëtare, ESG dhe standardet e tjera ndërkombëtare.
- Ekziston një politikë e sigurimit të cilësisë që mbulon të gjitha aspektet që lidhen me ofrimin e programit të studimit e cila është e disponueshme për publikun.
- Procedurat e sigurimit të brendshëm të cilësisë për programin e studimit përcaktohen nga rregulloret e brendshme të IAL (për shembull, rregullorja e sigurimit të cilësisë, udhëzimi për sigurimin e cilësisë, etj.).
- Programi i studimit mbështetet nga koordinatorët e sigurimit të cilësisë të institucionit/njesisë akademike, të cilët nuk kanë detyrime mësimore dhe janë të ngarkuar me monitorimin e programit të studimit.
- Politikat dhe proceset e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë formojnë një cikël për përmirësim të vazhdueshëm (PDCA).
- Ekziston një plan adekuat monitorues për zbatimin e procedurave të sigurimit të cilësisë për programin e studimit dhe të gjithë akterët janë të përfshirë në rishikimin e vazhdueshëm të tij.

Standardi 2.2 Programi i studimit i nënshtrohet një procesi hartimi dhe miratimi të vendosur nga IAL. (ESG 1.2)

Treguesit:

- Zhvillimi i programit të studimit është në përputhje me misionin dhe synimet strategjike të institucionit/njesisë akademike.
- Programi i studimit i është nënshtuar një procesi të brendshëm adekuat dhe transparent të sigurimit të cilësisë dhe është miratuar zyrtarisht nga organet e caktuara të menaxhimit strategjik të institucionit. Është planifikuar përmirësimi i vazhdueshëm i tij.
- Procesi për zhvillimin dhe miratimin e programit të studimit është i përcaktuar mirë dhe përfshin akterë të brendshëm dhe të jashtëm, duke përfshirë ekspertë të lëndëve specifike.
- Janë përcaktuar treguesit kryesorë të performancës për monitorimin e cilësisë së realizimit të programit të studimit, dhe arritja e këtyre treguesve monitorohet rregullisht.

Standardi 2.3 Programi i studimit monitorohet dhe rishikohet periodikisht për t'u siguruar që objektivat e tij janë arritur. Monitorimi i programit të studimit përfshin pjesëmarrjen e palëve të interesit. (ESG 1.9)

Treguesit:

- Programi i studimit i nënshtrohet monitorimit të rregullt për të vlerësuar ndërlidhshmërinë e tij me nevojat e shoqërisë (për shembull, anketat e punëdhënësve për kompetencat e nevojshme në tregun e punës, analizat e kryera në bashkëpunim me palët e interesit, shembuj të përmirësimeve bazuar në vlerësimet e palëve të interesuara për programin e studimit).
- Programi i studimit u nënshtrohet kontrolleve të rregullta për të konstatuar nëse caktimi i ngarkesës së vlerësuar të punës (ECTS) së studentëve dhe rezultatet e përcaktuara të të nxëniet janë të arritshme, realiste dhe adekuate.

- Palët e interesit, studentët, personeli, të diplomuarit dhe punëdhënësit janë të përfshirë në proceset e monitorimit të programit të studimit, i cili përfshin gjithashtu pyetësorë, diskutime në fokus grupe dhe rezultatet e vlerësimeve të tyre mbi ngarkesën e studentëve, suksesin akademik, burimet, punësimin e të diplomuarve, etj.
- IAL mund të dëshmojë se realizon rregullisht pyetësorë me palët e interesit (studentët, personeli, ish-studentët, punëdhënësit, etj.) dhe përfshin vlerësimet e tyre në proceset e rregullta të përmirësimit të programit të studimit.
- Nëse praktika studentore është pjesë përbërëse e programit të studimit, proceset për monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë së praktikave të studentëve janë të përcaktuara qartë, zbatohen vazhdimisht dhe përfshijnë vlerësimet e palëve të interesit (për shembull, pyetësorët e studentëve, mentorëve dhe punëdhënësve, shembuj të përmirësimit të praktikave të studentëve).
- Informacioni i mbledhur analizohet dhe ndërmerren veprime konkrete për të siguruar që programi të jetë i përditësuar.
- Rezultatet e proceseve të monitorimit dhe planet e veprimit që rezultojnë prej tyre u komunikohen të gjitha palëve të interesit dhe publikohen në faqen e internetit të IAL.

Standardi 2.4 I gjithë informacioni përkatës në lidhje me programin e studimit është i qartë, i saktë, objektiv, i përditësuar dhe është i disponueshëm për publikun. (ESG 1.8)

Treguesit:

- Të gjitha politikat, rregulloret dhe udhëzimet që kanë të bëjnë me programin e studimit janë të disponueshme për publikun.
- Publikohen informacione mbi kriteret e pranimit, njohjen e kualifikimeve, kuotat e regjistrimit, programet mësimore, rezultatet e të nxënit, kreditet, metodat e vlerësimit dhe kualifikimin përfundimtar.
- Informatat mbi shkallën e kalueshmërisë, shkallën e braktisjes dhe punësimin e të diplomuarve janë në dispozicion të publikut dhe paraqiten në mënyrë objektive.
- Informacioni në dispozicion të publikut lidhur me programin e studimit është i saktë, i besueshëm dhe objektiv dhe përditësohet rregullisht.

3 . Personeli akademik

Standardi 3.1 Ofrimi i programit të studimit mbështetet nga personeli mësimdhënës i cili është punësuar në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe rregulloret e brendshme në fuqi, dhe bazohet në procedurë objektive dhe transparente. (ESG 1.5)

Treguesit:

- IAL shpall vendet e lira të punës në nivelin kombëtar dhe atë ndërkombëtar (për shembull, faqja e IAL, Gazeta Zyrtare).
- IAL ka procese të qarta, objektive dhe transparente për rekrutimin e personelit dhe kushtet e punësimit (shembuj të procedurave të përfunduara të rekrutimit të mësimdhënësve, kopje të shpalljeve të vendeve të lira të punës, përbërja e komisioneve përzgjedhëse, raportet e komisioneve përzgjedhëse dhe vendimet e marra nga organet e ekspertëve).

- Institucioni i arsimit të lartë ka procedura të përshtatshme për përzgjedhjen e kandidatëve më të mirë për çdo pozitë (procedurat e punësimit të mësimdhënësve burojnë nga qëllimet strategjike të IAL dhe nevojat specifike të programeve të studimit, si dhe janë në përputhje me legjislacionin dhe rregulloret e brendshme në fuqi).
- Kandidatët për punësim pajisen me përshkrime të plota të pozitave dhe kushteve të punësimit (për shembull, rregulloret e brendshme të IAL, Kodi i Etikës për mësimdhënësit dhe studentët).

Standardi 3.2 Programi i studimit mbështetet nga personel i mjaftueshëm akademik i përhershëm, i cili është i kualifikuar në mënyrë adekuate për të ofruar programin e studimit. (ESG 1.5)

Treguesit:

- Numri dhe kualifikimet e personelit akademik (të zgjedhur në një klasë në një fushë dhe/ose lëmi të përshtatshme) janë të mjaftueshme për zbatimin e programit të studimit dhe për kryerjen e veprimtarisë shkencore/profesionale në nivelin e kërkuar (për shembull, CV, të dhëna për përqindjen e lëndëve të ofruara nga akademikë me kohë të plotë për programin e studimit, numri i mësimdhënësve me titull të doktoraturës).
- Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit angazhohet, brenda një viti akademik, në shumë se dy pozita të mësimdhënies (një me orar të plotë, një me orar të pjesshëm), pavarësisht prej institucionit arsimor ku zhvillon veprimtarinë e tij.
- Personeli akademik nuk duhet të mbingarkohet. Angazhimi i tyre nuk duhet të kalojë normat në krahasim me institucionet në Evropë sa u përket orëve mësimore dhe numrit të kurseve.
- Të paktën 50% e personelit akademik që përfshihet në ofrimin e programit të studimit janë punonjës me kohë të plotë në IAL (kontratat e punës).
- Për çdo grup studentësh (të përcaktuar nga statuti i IAL) dhe për çdo 60 ECTS në programin e studimit, IAL ka të punësuar të paktën një anëtar personeli me orar të plotë me titull të doktoraturës ose titull të barasvlefshëm në rastin e institucionit të artit/shkencave të aplikuara.
- Raporti i studentëve ndaj akademikëve me kohë të plotë për programin e studimit është 1:30 dhe është i përshtatshëm për arritjen e suksesshme të rezultateve të të nxënimit të programit (për shembull, raporti studentë-mësimdhënës dhe ndryshimet e tij me kalimin e kohës; planet e ardhshme në lidhje me raportin student-mësimdhënës).
- Kualifikimi i personelit akademik të angazhuar në realizimin e programit të studimit është adekuat dhe i përshtatshëm për lëndët që ligjërojnë (CV; botime; libra, etj.).
- Ngarkesa e personelit akademik është në përputhje me legjislacionin dhe aktet nënligjore përkatëse, rregulloret e nxjerra nga organet kompetente, etj.
- Ngarkesa e personelit akademik mundëson shpërndarjen e duhur të detyrimeve mësimore (duke përfshirë mentorimin e studentëve), punës profesionale dhe/ose shkencore, zhvillimit profesional dhe personal, si dhe detyrave administrative dhe shërbimit në komunitet.
- Janë punësuar një numër i mjaftueshëm i mentorëve të kualifikuar të cilët ofrojnë udhëzime për studentët e regjistruar në programin e studimit (për shembull, mentorë që mbështesin studentët në mësim dhe përparim si dhe në mentorimin e tezës përfundimtare).

Standardi 3.3 Programi i studimit mbështetet nga personeli mësimdhënës që i nënshtrohet avancimit dhe riemërimit bazuar në procedura objektive dhe transparente të cilat përfshijnë vlerësimin e ekselencës. Avancimi i personelit buron nga qëllimet strategjike të institucionit të arsimit të lartë dhe është në përputhje me legjislacionin dhe rregulloret e brendshme në fuqi. (ESG 1.5)

Treguesit:

- Procedurat e avancimit të mësimdhënësve të angazhuar në programin e studimit janë transparente dhe objektive (shembuj të procedurave të përfunduara të rekrutimit të mësimdhënësve, kopje të shpalljeve të vendeve të lira, përbërja e komisioneve përzgjedhëse, raportet e komisioneve përzgjedhëse dhe vendimet e marra nga organet e ekspertëve).
- Promovimi i personelit akademik në nivele më të larta bazohet në ekselencë dhe arritje të rëndësishme (kërkesat kombëtare për botimin në WoS dhe Scopus, aktiviteti mësimor, aktiviteti ndërkombëtar në disiplinën shkencore, publikimet me ndikim të lartë, projektet, mbikëqyrja e tezave përfundimtare, tekstet shkollore, vlerësimet nga studentët, etj.).
- Rezultatet e vlerësimit merren parasysh në avancimin dhe riemërimin e personelit mësimor dhe në vazhdimin e kontratave (për shembull, vlerësimi i personelit bazuar te studentët, menaxhmentin, pyetësorin e kolegëve dhe vetëvlerësimin).

Standardi 3.4 Personeli akademik i angazhuar në realizimin e programit të studimit ka të drejtën e mbështetjes institucionale për zhvillimin profesional. (ESG 1.5)

Treguesit:

- IAL ka një plan operacional vjetor për zhvillimin profesional të personelit akademik të angazhuar në programin e studimit dhe demonstroi pjesëmarrjen e tyre në aktivitetet e zhvillimit.
- Drejtimi i IAL dëshmon se i gjithë personeli akademik i angazhuar në programin e studimit është i përfshirë në programet e zhvillimit profesional (p.sh. trajnime gjuhësore, etj.).
- IAL ofron mbështetje për të gjithë personelin akademik të programit të studimit në zhvillimin e aftësive që lidhen me metodat e testimit dhe vlerësimit.
- IAL dëshmon se i gjithë personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitete ndërkombëtare (si programet e lëvizshmërisë, vizitat studimore në IAL të huaja, projektet ndërkombëtare, pushimet studimore, rrjetet, etj.), të cilat janë të rëndësishme për programin e studimit dhe personeli akademik inkurajohet dhe mbështetet nga vetë IAL për këto aktivitete.
- IAL ofron dëshmi se organizon trajnime specifike për personelin e tij akademik mbi mënyrën e përgatitjes dhe mbajtjes së mësimin dhe vlerësimit dhe e njofton atë lidhur me rregulloret dhe praktikatat në arsimin e lartë (për shembull, kreditë ECTS, rezultatet e të nxënësve, metodat e mësimdhënies, aftësitë e procesit të mbikëqyrjes, metodat e vlerësimit, etj.).
- Mësimdhënësit e sapopunësuar për realizimin e programit të studimit i nënshtrohen trajnimit adekuat për të forcuar kompetencat e mësimdhënies para se të fillojnë veprimtarinë e tyre mësimore në IAL.
- IAL siguron që anëtarët e personelit të sapopunësuar t'i nënshtrohen hyrjes adekuate me qëllim të njoftimit me praktikatat standarde të funksionimit të IAL, me theks te standardet dhe procedurat e SC-së, standardet e sjelljes etike, etj.
- IAL siguron mbështetje për personelin akademik në zhvillimin e programeve të tyre kërkimore nëpërmjet mekanizmave të ndryshëm si mentorimi nga kolegët e vjetër, ekipet e projektit, asistencën në zhvillimin e propozimeve kërkimore dhe financimi.

Standardi 3.5 Bashkëpunëtorët e jashtëm që japin mësim në programin e studimit kanë kualifikime dhe përvojë pune adekuate për realizimin e programit të studimit dhe arritjen e rezultateve të synuara të të nxënit. (ESG 1.5)

Treguesit:

- Bashkëpunëtorët e jashtëm përfshijnë kërkimet më të fundit, tendencat dhe njohuritë nga tregu i punës në procesin e mësimdhënies.
- Organizohen trajnime specifike për mënyrën e përgatitjes dhe mbajtjes së mësimin për bashkëpunëtorë të jashtëm nga sektori i biznesit dhe/ose nga jashtë. Trajnimi gjithashtu i njofton ata me rregulloret dhe praktikën në arsimin e lartë (për shembull, me kreditë ECTS, rezultatet e të nxënit, metodat e mësimdhënies dhe metodat e vlerësimit).
- Bashkëpunëtorët e jashtëm të angazhuar në programin e studimit inkurajohen të marrin pjesë në mbikëqyrjen e punimeve përfundimtare dhe të diplomimit (shembuj të bashkë-mbikëqyrjes).
- Ngarkesa e punës dhe pritshmëritë nga bashkëpunëtorët e jashtëm harmonizohen qartë për të siguruar që mësimi të kryhet me cilësi të lartë.

4. Përmbajtja e procesit arsimor

Standardi 4.1 Rezultatet e të nxënit të synuara të programit të studimit janë formuluar qartë, saktë dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse sipas praktikave më të mira; ato janë në përputhje me misionin dhe qëllimet strategjike të publikuara të institucionit/njesisë akademike dhe janë të disponueshme për publikun. (ESG 1.2)

Treguesit:

- Rezultatet e synuara të të nxënit të programit të studimit janë në përputhje me misionin e institucionit/njesisë akademike dhe qëllimet e tij strategjike (dëshmia e përafritit të secilit rezultat të synuar të të nxënit me misionin dhe qëllimet strategjike të institucionit të arsimit të lartë).
- Rezultatet e synuara të të nxënit janë në përputhje me qëllimet dhe objektivat e përgjithshme të programit të studimit (dëshmia e përafritit të secilit rezultat të synuar të të nxënit me qëllimet dhe objektivat e deklaruara të programit të studimit).
- Rezultatet e synuara të të nxënit të programit janë shkruar nga këndvështrimi i studentit; ato përshkruajnë atë që një i diplomuar në programin e studimit do të dijë dhe do të jetë në gjendje të bëjë (publikuar dhe shpjeguar në faqen e internetit të IAL).
- IAL dëshmon se ka përdorur shembuj të praktikave të mira në përcaktimin e rezultateve të synuara të të nxënit (ECTS Guide, 2015)
- Rezultatet e synuara të të nxënit janë të nivelit të treguar të studimeve dhe përfshijnë zhvillimin e kompetencave të përgjithshme dhe specifike, dhe ndahen në njohuri, aftësi dhe kompetenca.
- Rezultatet e synuara të të nxënit janë të krahasueshme me programe të ngjashme studimi në EHEA dhe është bërë përshtatja e rezultateve të të nxënit kundrejt programeve të tjera në EHEA.

Standardi 4.2 Rezultatet e të nxënit të synuar të programit të studimit janë në përputhje me përshkruesit e nivelit të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve dhe të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve. (ESG 1.2)

Treguesit:

- Rezultatet e synuara të të nxënit të programit të studimit janë në përputhje me Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve dhe përshkruesit e nivelit të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve (programi dhe planprogrami i programit të studimit).
- Nëse programi i studimit ofrohet në nivel pasuniversitar, rezultatet e synuara të të nxënit ndryshojnë nga rezultatet e të nxënit të arritura në nivelin universitar të programit të studimit.
- Rezultatet e synuara të të nxënit të programit të studimit përputhen me nivelin dhe profilin e kualifikimit të fituar dhe ato shmangin mbivendosjet ndërmjet programeve të ndryshme të studimit.

Standardi 4.3 Përmbajtja dhe struktura e kurrikulës është koherente dhe u mundëson studentëve të arrijnë rezultatet e synuara të të nxënit dhe të përparojnë pa probleme gjatë studimeve të tyre. (ESG 1.2)

Treguesit:

- Lëndët në kuadër të kurrikulës ofrohen në një rrjedhë logjike dhe plotësojnë përcaktimin dhe përkufizimin e saktë të kompetencave të përgjithshme dhe specifike, si dhe përputhshmërinë me programet e studimit dhe kurrikulat e ofruara në EHEA.
- Rregullat që përcaktojnë rendin e përparimit të studentëve nëpër kurset e programit sigurojnë që rezultatet e të nxënit të lëndëve të kaluara me sukses më parë të jenë të mjaftueshme për të përmbushur parakushtet e lëndëve të ardhshme në kurrikulë.
- Disiplinat themelore të nevojshme për arritjen e rezultateve të të nxënit dhe përvetësimin e kompetencave në fushat përkatëse mbulohen në mënyrë adekuate nga kurset e programit. (Është bërë hartëzimi i kompetencave në nivel kursi kundrejt rezultateve të të nxënit të programit).
- Programi i studimit është i krahasueshëm me programe të ngjashme studimi jashtë vendit dhe u mundëson studentëve të diplomuar lëvizshmëri horizontale dhe vertikale dhe punësim në tregun evropian dhe global (analiza krahasuese e programit të studimit të propozuar kundrejt programeve të ngjashme të akredituara të studimit në EHEA).

Standardi 4.4 Nëse programi i studimit pajis studentin me diplomë në profesione të rregulluara, ai është në përputhje me Direktivat e BE-së dhe shoqatat profesionale kombëtare dhe ndërkombëtare. (ESG 1.2)

- Programi i studimit është në përputhje me kushtet e përcaktuara në Direktivat e BE-së. (Është bërë përshtatja e përmbajtjes dhe parametrave të programit kundrejt kërkesave të të gjitha direktivave përkatëse).
- Përmbajtja e programit të studimit dhe aspektet e tjera të realizimit të tij kanë marrë parasysh dhe zbatuar rekomandimet e dhëna nga shoqatat profesionale (mendimi i odës profesionale, mundësia e ekzaminimit të licencës, etj.).

Standardi 4.5 Rezultatet e synuara të të nxënit të periudhës së praktikës së studentëve janë specifikuar qartë dhe proceset efektive ndiqen për të siguruar që rezultatet e të nxënit dhe strategjitë për të zhvilluar atë mësim të kuptohen nga studentët (nëse është e aplikueshme). (ESG 1.2)

- IAL ka hartuar një rregullore për praktikën që përfshin rezultatet e pritura të të nxënit, të drejtat dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshira dhe modele për të gjitha dokumentet e nevojshme për përfundimin e praktikës.
- Gjatë periudhës së praktikës, studentët kanë mentorë të caktuar prej radhëve të personelit akademik në programin e studimit. Praktika organizohet në mjedise të përshtatshme mësimore jashtë institucionit të arsimit të lartë, në bashkëpunim me tregun e punës (kontrata/marrëveshje me punëdhënësit, rregullore për praktikën e studentëve).
- Kreditë ETCS ndahen për punën praktike që monitorohet përmes raporteve të veprimtarisë (evidenca e praktikës së studentëve).
- Ofrimi i programit të studimit mbështetet nga marrëveshje bashkëpunimi, kontrata ose dokumente të tjera me institucionet/organizatat/njësitë e trajnimit praktik dhe reagimet mbi bashkëpunimin nga punëdhënësit që marrin pjesë në organizimin e praktikës studentore (vlerësimet nga mbikëqyrësit nga institucioni i arsimit të lartë ose jashtë tij, procesverbali i praktikës studentore).

Standardi 4.6 Programi i studimit realizohet përmes mësimdhënies dhe mësimnxënies me studentin në qendër. (ESG 1.3)

- Programi i studimit ka një koncept didaktik i cili i mbështet studentët në arritjen e rezultateve të të nxënit të programit.
- Programi i studimit realizohet përmes metodave të ndryshme pedagogjike që përputhen me rezultatet e synuara të të nxënit dhe janë adekuate për nivelin e studimeve.
- Përdoren metoda të ndryshme të mësimdhënies që inkurajojnë të nxënit ndërveprues dhe të bazuar në kërkime, zgjidhjen e problemeve dhe të menduarit kreativ e kritik, me udhëzime të përcaktuara qartë në përputhje me rezultatet e të nxënit.
- Për të ofruar programin e studimit, metodat e mësimdhënies dhe mënyrat e ndryshme të ofrimit të programit vlerësohen dhe përshtaten vazhdimisht.
- Metodat e mësimdhënies janë përshtatur për të mbështetur një popullsi të ndryshme studentore sipas kërkesës (studentët me orar të pjesshëm, studentët më në moshë, studentët ndërkombëtarë, studentët me vështirësi në të nxënë dhe nevoja të veçanta, etj.).
- Ofrimi i programit të studimit sigurohet përmes përdorimit të teknologjisë moderne.

Standardi 4.7 Vlerësimi i përdorur në programin e studimit është objektiv dhe konsistent dhe siguron që janë arritur rezultatet e synuara të të nxënit. (ESG 1.3)

- Programi përshkruan qartë lidhjen ndërmjet rezultateve të përgjithshme të synuara të të nxënit (njohuritë, aftësitë dhe kompetencat) dhe kontributin e dhënë nga secili modul individual për arritjen e këtyre rezultateve të të nxënit.
- Metodologjitë e vlerësimit të cilat zbatohen në program sigurojnë vlerësim sistematik të rezultateve individuale të të nxënit që lidhen me të gjitha fushat përkatëse të njohurive, aftësive dhe kompetencave, siç përcaktohen në rezultatet e të nxënit të programit (është bërë përshtatjen e metodave të vlerësimit kundrejt rezultateve të të nxënit të programit të studimit).
- Kriteret dhe metodat e vlerësimit, si dhe kriteret e notimit për programin e studimit, publikohen paraprakisht dhe të gjithë studentët njoftohen lidhur me to.
- Programi i studimit siguron notim objektiv dhe të besueshëm të studentëve.

- Studentët njoftohen me kohë për rezultatet e vlerësimit që identifikojnë pikat e forta dhe të dobëta të tyre, dhe nëse është e nevojshme, marrin udhëzime për procesin mësimor bazuar në këto vlerësime.
- Ekziston një procedurë funksionale e ankimit nga studentët lidhur me programin e studimit (shembuj të procedurave të ankimit).

Standardi 4.8 Rezultatet e të nxënit vlerësohen sipas ngarkesës së studentëve dhe shprehen në ECTS. (ECTS 1.2)

- Kriteret e vlerësimit duhet të shprehin atë që studentët dinë dhe mund të bëjnë si rezultat i demonstrimit të rezultateve të të nxënit.
- Ngarkesa e punës llogaritet dhe ECTS caktohet për të gjitha aktivitetet mësimore që çojnë në rezultatet e të nxënit të programit, duke përfshirë rezultatet e të nxënit të komponentëve të programit.

5. Studentët

Standardi 5.1 Politikat e qarta të pranimit, duke përfshirë kërkesat, kriteret dhe proceset për programin e studimit, janë të përcaktuara qartë dhe janë të disponueshme për publikun. (ESG 1.4)

Treguesit:

- Kërkesat dhe kriteret për pranim në programin e studimit, si dhe të gjitha proceset përcaktohen në mënyrë të qartë dhe gjithëpërfshirëse dhe publikohen (kriteret e pranimit për studentët e vendit dhe ata ndërkombëtarë, kërkesat kombëtare veçmas për nivelin bachelor dhe master, vlerësimet shitesë të njohurive dhe aftësive, etj).
- Studentët e regjistruar në një program studimi bachelor duhet të kenë diplomë të shkollës së mesme ose dokumente të tjera ekuivalente të studimit (rezultatet e Maturës Shtetërore) sipas kërkesave kombëtare. Për një program studimi master, studentët duhet të kenë diplomë të nivelit bachelor.
- Procesi i pranimit në programin e studimit siguron përzgjedhjen e kandidatëve me njohuri dhe kompetenca të duhura paraprake (për shembull, procedura e përcaktuar e vendimmarrjes në lidhje me kriteret e pranimit.)
- Kriteret dhe procesi i pranimit zbatohen në mënyrë konsistente dhe të drejtë për të gjithë studentët dhe parandalojnë diskriminimin.
- IAL ka procedura adekuate për periudhat e njohjes së studimit.

Standardi 5.2 Të dhënat mbi përparimin e studentëve për programin e studimit mblidhen dhe analizohen rregullisht. Ndërmerren veprimet e duhura për të siguruar përfundimin e programit të studimit nga studenti. (ESG 1.4)

Treguesit:

- Është krijuar një sistem funksional për monitorimin e përparimit të studentëve dhe ai u jep ndihmë dhe/ose këshillim atyre që përballen me vështirësi.

- Programi i studimit i nënshtrohet monitorimit të rregullt të shkallës së përparimit të studentëve dhe shkallës së përfundimit nga ana e studentëve. Nëse është e nevojshme, ndërmerren veprimet e duhura.
- Rezultatet e monitorimit të rregullt të progresit të studentëve u shpërndahen personelit dhe studentëve.
- Programi i studimit përcakton qartë mundësitë e ecurisë në drejtim të vazhdimit të studimit ose ndryshimit të studimit. Studentët informohen se çfarë mund të arrijnë me kualifikimet e tyre.
- Programi i studimit u nënshtrohet politikave në fuqi për transferimin ose njohjen e kualifikimeve të fituara nga institucione të tjera.

Standardi 5.3 Programi i studimit siguron kushte dhe mbështetje të përshtatshme për studentët që dalin dhe ata që vijnë (studentët vendas dhe ndërkombëtarë). (ESG 1.4)

Treguesit:

- Studentët e regjistruar në programin e studimit informohen rregullisht për mundësitë e programeve të lëvizshmërisë së shkëmbimeve ndërkombëtare.
- Studentët e regjistruar në programin e studimit mbështeten dhe stimulohen për t'u përfshirë në programet ndërkombëtare të lëvizshmërisë së shkëmbimeve (për shembull, Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar).
- IAL ka rregullore për njohjen e kredive ECTS.
- IAL publikon informacion mbi procedurat dhe kushtet e aplikimit si dhe pranimin në programin e studimit në gjuhë të huaj.
- IAL tërheq në mënyrë aktive studentë të huaj dhe u ofron atyre mbështetje kur studiojnë në një IAL të vendit.
- IAL ofron kurse të gjuhës së huaj për studentët e huaj.
- IAL mbledh dhe analizon vlerësimet nga studentët vendas dhe ndërkombëtarë dhe merr masat e duhura për të përmirësuar procedurat e shkëmbimit ndërkombëtar.
- IAL jep informacion se sa studentë të regjistruar në programin e studimit morën pjesë në lëvizshmëri ndërkombëtare deri në tre muaj dhe më shumë se tre muaj në periudhën e pesë viteve të fundit (lëvizshmëri hyrëse dhe dalëse).

Standardi 5.4 Ofrimi i programit të studimit sigurohet përmes burimeve adekuate për mbështetjen e studentëve. Ai merr parasysh nevojat e një popullate të larmishme studentësh (studentë me orar të pjesshëm, studentë më në moshë, studentë nga jashtë, studentë nga grupet e nën-përfaqësuar dhe të cenueshme, studentë me vështirësi në të nxënë dhe aftësi të kufizuara, etj.). (ESG 1.6)

Treguesit:

- Numri i personelit profesional, administrativ dhe teknik që është i përfshirë në ofrimin e mbështetjes së studentëve për programin e studimit është i mjaftueshëm dhe i kualifikuar në mënyrë adekuate.
- Studentët informohen për shërbimet (pakot e informacionit për studentët e rinj, rregulloret për studimin, rregulloret për organizimin e brendshëm, etj.) që janë në dispozicion të publikut.
- Studentëve të regjistruar në programin e studimit u ofrohen udhëzime për mundësitë e studimit dhe karrierës (për shembull, tutorët, mbikëqyrësit dhe këshilltarët e tjerë për të mbështetur mësimin dhe përparimin e studentëve).

- Strukturat dhe procedurat e ankimimit dhe ankesës për programin e studimit janë të përcaktuara qartë dhe janë transparente për të gjithë studentët.
- Studentët e regjistruar në programin e studimit informohen për aktivitetet jashtëshkollore dhe IAL ka në dispozicion fonde për të mbështetur nismat e tyre (për shembull, IAL ka hapësira për sport dhe rekreacion, për aktivitete kulturore dhe vullnetare).

6. Kërkimi shkencor

Standardi 6.1. Programi i studimit përputhet me misionin e institucionit/njesisë akademike dhe synimet strategjike të kërkimit.

Treguesit:

- Programi i studimit ka përcaktuar objektivat e kërkimit shkencor/aplikativ që pasqyrohen në planin e zhvillimit të kërkimit të IAL (strategjia e kërkimit).
- Zbatimi i programit të studimit sigurohet përmes burimeve të mjaftueshme financiare, logjistike dhe njerëzore të ofruara nga institucioni për arritjen e objektivave të propozuara kërkimore.
- Programi i studimit u nënshtrohet politikave të qarta që përcaktojnë kërkimin e njohur dhe lidhen me standardet ndërkombëtare dhe normat e vendosura në fushën e programit të studimit.

Standardi 6.2. Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit angazhohet dhe mbështetet për të realizuar punë kërkimore dhe/ose veprimtari profesionale cilësore.

Treguesit:

- Veprimtaria kërkimore dhe/ose profesionale e personelit akademik vërtetohet nëpërmjet publikimeve kërkimore shkencore dhe të aplikuara, produkteve artistike, transferimeve teknologjike, qendrave të konsulencës, parqeve shkencore dhe/ose veprimtarisë profesionale.
- Personeli akademik publikon punën e tij në botime shkencore ose profesionale me cilësi të lartë, kërkimet ose arritjet profesionale të tyre prezantohen në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, ata marrin pjesë në projekte si konsulentë (për shembull, për programet e studimit akademik dhe shkencor, duhet të respektohen kërkesat kombëtare për publikimin dhe promovimin).
- Personeli akademik që është i përfshirë në ofrimin e programeve të studimit bachelor profesional ka një diplomë minimale master dhe të paktën pesë vjet aktivitete profesionale përkatëse.

Standardi 6.3 Personeli akademik i angazhuar në ofrimin e programit të studimit inkurajohet të marrë pjesë në aspekte të ndryshme të bashkëpunimit me partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

Treguesit:

- Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit është i përfshirë në identifikimin dhe shfrytëzimin e ekspertizës së tij dhe ofrimin e shërbimeve të kërkimit dhe zhvillimit për komunitetin.
- Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit është i përfshirë në zhvillimin e marrëveshjeve kërkimore bashkëpunuese me kolegë nga IAL të tjera nga vendi dhe jashtë vendit.

- Personeli mësimdhënës i angazhuar në programin e studimit mbështetet për të bashkëpunuar me partnerët lokalë të biznesit nëpërmjet projekteve të përbashkëta kërkimore, strategjive bashkëpunuese për zhvillim dhe përdorimit të përbashkët të pajisjeve kur është e mundur.
- Personeli mësimdhënës i angazhuar në programin e studimit mbështetet dhe përfshihet në transferimin e teknologjisë dhe bashkëpunimin për transferimin e njohurive me industrinë dhe sektorin publik.

Standardi 6.4 Personeli mësimdhënës i angazhuar në programin e studimit ka një histori të dëshmuar të rezultateve kërkimore për të njëjtat tema me veprimtarinë e tyre mësimore.

Treguesit:

- Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit inkurajohet të përfshijë në mësimdhënien e tyre rezultatet e kërkimit të tyre dhe informacionin në lidhje me aktivitetet e tyre shkencore në lëndët që ata mbajnë.
- Studentët e regjistruar në programin e studimit angazhohen në veprimtari kërkimore me personelin akademik.

7. Infrastruktura dhe burimet

Standardi 7.1. IAL siguron ambiente dhe pajisje të përshtatshme për kryerjen e proceseve arsimore dhe kërkimore. ESG (1.6)

Treguesit:

- IAL ka ambiente dhe pajisje të përshtatshme për kryerjen e veprimtarive arsimore dhe kërkimore.
- Laboratorët (nëse ka) për të gjitha aktivitetet e detyrueshme në kuadër të kurrikulës së programit të studimit, sa herë që planprogrami analitik përfshin aktivitete të tilla, janë të pajisur mirë me teknologji të TIK-ut.
- IAL ka softuerë të përshtatshëm për disiplinat e studimit të përfshira në kurrikulë, me licencë të vlefshme.
- Hapësira, pajisjet dhe e gjithë infrastruktura (laboratorët, shërbimet e TIK-ut, ambientet e punës, etj.) janë plotësisht funksionale dhe në gjendje për të plotësuar numrin e studentëve të regjistruar në program. Ato mbështesin arritjen e rezultateve të të nxënësve të synuar të programit të studimit veçmas nga programet e tjera të studimit të ofruara nga institucioni. (Shqyrtimi i ambienteve nga anëtarët e panelit gjatë vizitës në IAL, informacioni për objektet, dokumentet e pronësisë, dokumenti që vërteton të drejtën e përdorimit të ambienteve dhe pajisjeve në periudhën pesëvjeçare, numri optimal i studentëve të regjistruar në programin e studimit në raport me hapësirën në dispozicion, pajisjet dhe numrin e mësimdhënësve).
- Ambientet dhe pajisjet e dedikuara për zbatimin e programit të studimit janë përshtatur për studentët me nevoja të veçanta.

Standardi 7.2 IAL siguron burime të përshtatshme bibliotekare për programin e studimit. (ESG 1.6)

Treguesit:

- Biblioteka është e pajisur me sallat e leximit, dhomat e punës në grup dhe librarinë e saj sipas lëndëve të përfshira në programin e studimit.

- Biblioteka dhe shërbimet e saj janë të disponueshme pas orarit të mësimit për të siguruar qasje kur kërkohet nga përdoruesit.
- Biblioteka siguron që numri i vendeve në sallat e leximit të jetë i mjaftueshëm për gjithsej studentët e regjistruar në programin e studimit.
- Biblioteka duhet të sigurojë që numri i vendeve në dhomat e punës në grup të jetë i mjaftueshëm për numrin e përgjithshëm të studentëve të regjistruar në programin e studimit.
- Biblioteka ka stokun e saj të librave dhe burime të tjera elektronike nga literatura e specializuar shqiptare dhe e huaj, të mjaftueshme për të mbuluar lëndët specifike në kuadër të kurrikulës dhe nevojat e të gjithë studentëve. Biblioteka duhet të ketë tituj librash të përshtatshëm dhe të kohëve të fundit ose kurse specialiteti të botuesve të njohur.
- Biblioteka ka një numër të mjaftueshëm abonimesh në botime dhe revista periodike vendase dhe të huaja.

Standardi 7.3 Programi i studimit financohet në mënyrë të përshtatshme për të ofruar aktivitetet e synuara arsimore dhe kërkimore. (ESG 1.6)

Treguesit:

- IAL siguron që të ketë një plan financiar në nivel programi studimi, i cili demonstroi qëndrueshmërinë e programit të studimit për pesë vitet e ardhshme.
- IAL përfiton burime shtesë për financimin e programit të studimit përmes projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe bashkëpunimit me partnerët e biznesit dhe komunitetin vendas.
- IAL përdor burime financiare shtesë për zhvillimin dhe përmirësimin e programit të studimit.

Njoftim:

Për programet e studimit në të cilat studenti merr diplomë të Mjekësisë së Përgjithshme (Dr. i Mjekësisë), përveç standardeve të cilësisë për akreditim dhe riakreditim, IAL duhet të dëshmojë me dokumentacion dhe dëshmi adekuate se ka funksionale dhe posedon klinikat dhe shërbimet shëndetësore të parapara.*

**Hollësitë janë shpjeguar në Manualin e Akreditimit.*